

Analiza vjetore për vitin 2021

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Financës.

Në datën 07 shkurt 2022, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, në zbatim të Urdhrit nr. 8, datë 18.01.2022 të Kryetarit të KLSH, “Për Kryerjen e Analizës Vjetore të Veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së, për Vitin 2021”, zhvilloi në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, analizën vjetore të vitit 2021, duke u fokusuar në këto drejtime :

- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin ligjor dhe rregullator.
- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin organizativ.
- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin financiar.
- Fuqitë dhe dobësitë e drejtorisë në aspektin komunikues.
- Mundësitë për përmirësim dhe risqet në të gjitha sa përmendur më sipër.

Në këtë analizë morën pjesë drejtuesit të Drejtorisë IT, drejtuesve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe drejtuesve të Sektorit të Financës, pjesëmarrës në këtë analizë ishte dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit, znj. Valbona Gaxha.



Fjalën hapëse të analizës vjetore të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorit të Financës e mbajti Sekretarja e Përgjithshme e KLSH-së, znj. Valbona Gaxha, e cila së pari shprehu falënderimet për punën e kryer nga punonjësit e strukturave të sipërpërmendura në drejtim të kryerjes së detyrave funksionale për krijimin e kushteve optimale për mbështetjen e procesit auditues dhe në vijim bëri një analizë të përmbledhur të funksionimit të drejtorisë për vitin 2021 dhe orientoi objektivat kryesore për vitin 2022.

Qasja strategjike e KLSH-se për krijimin e një ambienti bashkëkohor të IT ka konsistuar në orientimin e buxheteve e investimeve në instalimin e platformave IT në funksion të modernizimit të menaxhimit të proceseve të auditimit dhe atyre logjistike mbështetëse.

Gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të institucionit, si rezultat i intensitetit të lartë të punës, gjatë proceseve të auditimit dhe atyre administrative, gjenerohet një fluks i madh informacioni, i cili duke u konsideruar si një aset i çmuar i institucionit dikton domosdoshmërinë për kontrollim, përpunim dhe ruajtjen e integritetit dhe disponueshmërisë së tij.

Nisur nga sa më sipër, në këtë analizë u prezantua puna e kryer nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit përgjatë vitit 2021, në mbështetje të procesit auditues, e cila kryesisht ka konsistuar në:

Dhënien e mbështetjes teknike për përdorimin e sistemit të informacionit SIMMPA. Realizimin e trajnimeve të brendshme në lidhje me teknologjinë e informacionit në përgjithësi dhe me sistemin e informacionit SIMMPA në veçanti për stafin auditues, në bashkëpunim me Departamentin e Metodologjisë dhe Standardeve. Përdorimin e praktikave dhe metodave më të mira, në funksion të krijimit të kushteve optimale në mbështetje të procesit auditues, duke krijuar linjën e parë mbështetëse në lidhje me teknologjinë e informacionit për të gjithë stafin e KLSH. Mirëmbajtjen e një ambienti teknologjik që i përshtatet nevojave dhe kërkesave të institucionit. Bashkëpunimin midis punonjësve të drejtorisë me njëri-tjetrin dhe me strukturat drejtuese të institucionit. Hartimin dhe aplikimin e dokumenteve dhe manualeve si korniza rregullative për mirëfunksionimin e drejtorisë.

-Drejtuasi i drejtorisë së IT, prezantoi pranë strukturave drejtuese të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kolegëve pjesëmarrës në këtë analizë të gjithë kapacitetet teknologjike që zotëron institucioni dhe që janë shfrytëzuar përgjatë vitit 2021 me kapacitet të plotë për të dhënë mbështetjen optimale për procesin auditues. Ndër të tjera në këtë analizë u cilësua dhe fakti se përgjatë vitit 2021, vit në të cilin transmetimi i informacionit në rrugë elektronike u shumëfishua, jo vetëm për Kontrollin e Lartë të Shtetit por për çdo institucion publik e privat, ashtu sikurse edhe rreziqet për sulme kibernetike, sistemet IT të KLSH garantuan disponueshmëri, integritet dhe konfidencialitet të informacionit. Në mbyllje të analizës vjetore të veprimtarisë së drejtorisë së IT për vitin 2021, u përcaktuan disa objektiva për vitin 2022 të cilat kryesisht konsistojnë në përmirësim e aspektit rregullator-administrativ si dhe intensifikimin e zhvillimit të trajnimeve që lidhen me teknologjinë e informacionit.

-Në prezantimin që beri Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, u ndal në detyrat që mbulon drejtorja, në punën e bërë, në pritshmëritë për vitin 2022 dhe në problematikat e hasura. Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse përgjigjet për krijimin e kushteve të punës për punonjësit e institucionit, parashikon në projekt buxhetin e vitit pasardhës nevojat për paisje dhe materiale, merr pjesë në hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve, përgjigjet për administrimin ligjor të mjeteve të transportit, mirëmbajtjen dhe kryerjen e shërbimeve teknike të tyre, etj.

U raportua mbi gjendjen e ambienteve të institucionit dhe parkut të mjeteve të transportit, për ndërhyrjet që janë bërë në rrjetin elektrik, hidraulik, në punimet e kryera në ambientet e KLSH, për zgjerimin e kapaciteteve të vendeve të punës. Për vitin 2022 u theksuan nevojat që ka institucioni për paisje dhe mirëmbajtje të cilat janë parashikuar në buxhet si dhe u raportua mbi ecurinë e kontratave të shërbimeve për nevojat e institucionit.

-Në prezantimin e bërë nga Përgjegjësja e Sektorit të Financës në lidhje me veprimtarinë e këtij sektori, ndër të tjera u cilësua fakti se për vitin 2021, është kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022. Për vitin 2021, Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së për vitin 2021, është realizuar në masën **348,982 mijë lekë**. Gjatë vitit 2021, u bë i mundur rikonstruksioni i ambienteve të brendshme i cili erdhi si domosdoshmëri pasi me Aktin Normativ të KM, nr. 26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar”, për KLSH, është miratuar një shtesë në numrin e punonjësve për 15 punonjës, pra numri i punonjësve të miratuar për KLSH, për

vitin 2021 është 218 punonjës. Fondet për këtë qëllim janë siguruar nga fondet e miratuara për “Pajisje informatike”, kjo pasi KLSH ka rezultuar me një kursim fondesh në vlerën për 3,015 mijë lekë nga kryerja e procedurave të prokurimit si dhe për arsye objektive ka anuluar një procedura prokurimi të këtij zëri.

Politika Buxhetore e KLSH-së edhe në vijim është e fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2018-2022.